

I nderuar Z. Kryetar i Gjykatës së Lartë,

Së pari, na lejoni t'iu falënderojmë për mesazhet tuaja përbashkuese në këto ditë të vështira për pushtetin gjyqësor. Ndërgjegjësimi për sfidat e pazakonta në të cilat gjyqtarët e republikës janë duke kaluar, edhe pas reformimit të shumëpritur të sistemit të drejtësisë, si dhe sinjalet e unitetit dhe të udhëheqësisë janë gjithnjë të mirëseardhura. Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë ka qenë dhe do të mbetet gjithnjë një mbështetëse e palëkundur e vlerave më të larta gjyqësore si dhe një garante e pavarësisë së gjyqtarëve. Me aksionet tona ligjore, deklaratat në mbrojtje të figurës së magistratëve por edhe këshillimin në fushën e hartimit të legjislacionit, ne kemi treguar se jemi përherë aktivë në misionin tonë të përbashkët, forcimin e pushtetit gjyqësor, si një degë e barabartë me dy pushtetet e tjera.

Së dyti, ju bëjmë me dije se, në vijim të veprimtarisë sonë të pandërprerë, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, ditën e premte, më datë 31.10.2025, zhvilloi punimet, duke marrë disa vendime të rëndësishme, ndër të cilët, pranimi i anëtarëve të rinj në gjirin e saj, si dhe zgjedhja e Kryetarit, Nënkryetarit, Sekretarit dhe Këshillit Drejtues të Shoqatës. Lidhur me këtë takim, Shoqata ka njoftuar të gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë për të shprehur interesin e tyre për anëtarësimin në të, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë. Në këtë drejtim, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, si organizimi i parë vullnetar i gjyqtarëve në vendin tonë, ka qenë gjithnjë e hapur jo vetëm në drejtim të pranimit të anëtarëve të rinj, çka është treguar qartë edhe nga historiku i saj i pasur i anëtarësimeve, por edhe në ndërmarrjen e nismave të përbashkëta me organizma simotra të vendit tonë, duke përfshirë këtu edhe bashkimet eventuale. Megjithatë, ekzistenca e disa shoqatave të gjyqtarëve nuk shihet asnjëherë nga ana jonë si një përçarje ndërmjet veti por si një pasurim i mozaikut gjyqësor. Jo pak herë shoqatat e gjyqtarëve kanë qenë përplotësuese të njëra – tjetrës në ndërmarrjen e aksioneve të ndryshme në mbrojtje të gjyqësorit. Kjo tregon se shumëllojshmëria e tyre përbën një vlerë të shtuar në sistem dhe nuk ka pse shihet si pengesë në realizimin e qëllimit të përbashkët.

I nderuar Z. Kryetar, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë asnjëherë nuk ka qenë pengesë në unifikimin e të gjithë gjyqtarëve të angazhuar në këtë veprimtari si një trup i vetëm. Megjithatë, shoqata jonë ka pasur gjithnjë si një kusht të panegociueshëm bazimin në parime dhe vlera të organizimit dhe veprimtarisë së bashkimeve të tilla. Shoqatat e gjyqtarëve duhet tu shërbejnë pa kushte të mirës sonë të përbashkët, fuqizimit të statusit të magistratit, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më të mirë gjyqësor, forcimin e besimit të publikut në institucionet shtetërore, veçanërisht në ato të drejtësisë dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës. Nga ana tjetër, shoqatat tona nuk duhet tu shërbejnë kurrësesi emrave apo agjendave të veçanta, pasi kjo do t'iu tëhuajësonte nga qëllimi i ekzistencës së tyre. Në fund të fjalës sonë, duam të theksojmë se ne mbetemi të hapur, bashkëpunues dhe mikpritës për çdo iniciativë të sinqertë në sa u parashtrua më sipër, që i shërben më së miri komunitetit tonë.

Për Shoqatën Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë

KRYETARI
Engert PËLLUMBI